



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 27 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare që do të pranohen nga Drejtoria e Shëndetësisë gjatë vitit 2026. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
 - 1.1. Dr. Florije Avdylaj, specialiste e mjekësisë familjare,.....nga QKMF, kryesuese,
 - 1.2. Fatlum Berisha, zyrtar për shëndetësi,nga DSh, anëtar,
 - 1.3. Qendresa Racaj, zyrtare ligjore,.....nga DSh, anëtare,
 - 1.4. Shpejtim Rramanaj, udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi,... anëtar rezervë,
 - Detyrat e Komisionit, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë që në afat sa më të shkurtër kohor të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, të cilat i drejtohen Drejtorisë së Shëndetësisë për mbështetje financiare konform Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.
 - Komisioni përzgjedh aplikacionet që i plotësojnë kriteret për mbështetje financiare sipas rregullores përkatëse dhe, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë i propozon Kryetarit të Komunës miratimin e mbështetjes financiare.
 - Komisioni i propozon Drejtorisë së Shëndetësisë refuzimin e aplikacioneve që nuk i plotësojnë kriteret e parapara konform rregullores.
 - Mandati i Komisionit zgjat deri më 31.12.2026.
 - Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Komisionit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

